



Raporti i Ekspertit

Mbi Bashkimin e Veneto Bank ShA me Intesa Sanpaolo Bank Albania ShA

Drejtuar: Aksionerëve të Intesa SanPaolo Bank Albania Sh.A dhe Veneto Banka Albania Sh.A

(1) Hyrje dhe qëllimi

"DK Audit shpk", një kompani auditimi me NIPT: L62109018C dhe Licencë Profesionale nr. 362 (bashkëlidhur një kopje e licencës dhe profili i shoqërisë), i paraqet aksionerëve të Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A dhe Veneto Banka Albania Sh.a (më poshtë referuar "Aksionerët") këtë **"Raport të ekspertit mbi bashkimin e Veneto Banka ShA me Intesa Sanpaolo Bank SHA"**.

Ky raport bazohet në dokumentacionin dhe kërkesat e mëposhtme:

- Pasqyrat Financiare të Certifikuara të Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A dhe Veneto Banka Albania Sh.a (Bankat) për vitin ushtrimor deri më 31 dhjetor 2017;
- Plani i Bashkimit të Grupit për Shqipërinë; ISP AI - Veneto, datë ___ Prill 2018 (më poshtë referuar "Plani i Bashkimit");
- Marrëveshja e Bashkimit midis Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.A dhe Veneto Banka Albania Sh.a (më poshtë referuar "Marrëveshja e Bashkimit");
- Kërkesat e Ligjit Nr.9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare " (Ligji për Shoqëritë), Seksioni IX "Mbi riorganizimin e shoqërive ";
- Kërkesat e nenit 20, pika 2, shkronja "c" e rregullores nr. 14 të Bankës së Shqipërisë (BSH) "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë".

DK Audit Shpk siguron se Plani i Bashkimit dhe Marrëveshja e Bashkimit midis Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a. (ISP Albania) dhe Veneto Banka Albania Sh.a (VB Albania), datë 4 Maj 2018 nuk përmbajnë asnjë gabim material.

Ne kemi kryer procedurat e mëposhtme për të garantuar sigurinë e arsyeshme se Plani i Bashkimit dhe Marrëveshja e Bashkimit nuk përmbajnë ndonjë gabim material:



- Ne kemi verifikuar Planin e Bashkimit dhe Marrëveshjen e Bashkimit lidhur me transferimin e të gjitha aktiveve dhe detyrimeve nga Banka Veneto ShA tek Intesa Sanpaolo Bank ShA;
- Ne kemi analizuar dhe shqyrtuar qasjen e përdorur në Planin e Bashkimit dhe Marrëveshjen e Bashkimit në lidhje me përcaktimin e raportit të shkëmbimit të aksioneve (nëse është e aplikueshme); dhe
- Ne kemi analizuar dhe shqyrtuar sfidat dhe vështirësitë lidhur me vlerësimin e Bankave (nëse ka).

Bazuar në termat dhe kushtet e Planit të Bashkimit dhe Marrëveshjes së Bashkimit:

- Aksioneri aktual i Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a. është Intesa Sanpaolo S.p.A (më poshtë referuar "ISP SpA") e cila zotëron 100% të kapitalit aksioner të Intesa Sanpaolo Bank Albania.
- Aksioneri aktual i Veneto Banka Albania Sh.A është Intesa Sanpaolo S.p.A (ISP SpA) që zotëron 100% të kapitalit të Veneto Banka Albania ShA.
- Veneto Bank Albania do të përthithet nga dhe bashkohet me Intesa Sanpaolo Albania. Në bazë të dispozitave të Seksionit IX të Ligjit për Shoqëritë, Veneto Bank Albania do të transferojë tërësisht të gjitha aktivet dhe detyrimet e saj dhe ekzistenca më vete e Veneto Bank Albania do të përfundojë dhe Intesa Sanpaolo Albania do të jetë Kompania Përthithëse dhe do të vazhdojë ekzistencën e saj si korporatë nën emrin e saj: "INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA.

(2) Përgjegjësitë

1. Drejtimi dhe menaxhimi i Intesa Sanpaolo Bank Albania Sh.a dhe i Veneto Banka Albania Sh.a janë përgjegjës për përgatitjen e Planit të Bashkimit dhe Marrëveshjes së Bashkimit dhe raportit të propozuar të këmbimit (nëse është e aplikueshme) për trajtimin e kapitalit;
2. Qëllimi i kompanisë DK Audit, në rolin e ekspertit të pavarur, është të sigurojë respektimin e kërkesave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare në rast bashkimi, i cili do të konfirmojë arsyetimin e vlerave përkatëse që u janë caktuar çdo aksioni të kompanive që marrin pjesë në bashkim dhe konfirmojnë se raporti korrespondues i këmbimit për aksion është i arsyeshëm (nëse aplikohet) ose qasja dhe metoda e Bankave që është përdorur për bashkimin e njësive ekonomike është e drejtë. Kjo punë nuk është përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, pasi ato nuk janë relevante për këtë rast angazhimi.

(3) Procedurat e realizuara

a) Informacioni që përdoret për analizën tonë dhe përgatitjen e këtij raporti.



Për përgatitjen e këtij raporti kemi marrë në konsideratë Pasqyrat Financiare të Bankave më 31 Dhjetor 2017. Sipas opinionit të auditorit përkatës të pavarur, pasqyrat financiare të bankave paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankave më 31 Dhjetor 2017, ecurinë e saj financiare dhe flukset monetare të saj për vitin ushtrimor të mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Aplikimi i opsionit për konsolidimin retrospektiv të subjekteve të bashkimit, Bilanci i parë pas bashkimit i ISP Albania do të paraqitet si rezultat i inkorporimit të njëkohshëm të bilancit dhe gjendjes së Pasqyrës së të ardhurave të Veneto Bank Albania në Intesa Sanpaolo Albania në datën 01/01/2018 deri në Datën e Mbylljes, të miratuar nga Banka e Shqipërisë dhe Qendra Kombëtare e Biznesit.

b) Transferimi i Aktiveve dhe Detyrimeve:

Efektive në datën e mbylljes, ISP Albania do të jetë pasardhësi, nëpërmjet bashkimit me përthithje, të VB Albania në çdo dhe të gjitha kontratat, aktet dhe marrëdhëniet në të cilat VB Albania është palë. Rrjedhimisht, të gjitha aktivet materiale dhe jomateriale, të cilat paraqiten dhe prezantohen si aktivi dhe detyrimet, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore dhe kreditë si dhe të gjitha pronat e paluajtshme, marrëdhëniet kontraktuale dhe marrëdhënie të tjera juridike dhe pozicione juridike të çfarëdo lloji, të arkëtueshmet dhe detyrimet, detyrimet potenciale dhe të ardhurat e ardhshme dhe të kushtëzuara të VB Albania, do të transferohen tek ISP Albania.

Aktivet dhe detyrimet që do të transferohen do të përfshijnë në mënyrë të veçantë, por nuk do të kufizohen në sa më poshtë vijon:

- Të gjitha markat tregtare, modelet e dizajnit, patentat, njohuritë, ekspertizën dhe të drejtat e tjera intelektuale të VB Albania;
- Çdo dhe të gjitha aktivet dhe të drejtat mbi pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, aktive material dhe jomateriale, pa asnjë kufizim ose përjashtim, të cilat i përkasin ose do t'i përkasin VB Albania;
- Licenca, koncesione, autorizime dhe të drejta të ngjashme të VB Albania;
- Bazën e klientëve të VB Albania;
- Çdo kontratë qiraje, sigurimi, furnizimi, shitje, konsultimi, kontrata shërbimi dhe kontratat në të cilat VB Albania është palë, qoftë të lidhura tashmë ose që janë aktualisht në proces negociimi;
- Çdo kredi, borxh, depozitë të çdo lloji të krijuar nga VB Albania;
- Çdo dhe të gjitha të drejtat që lidhen më ndonjë dhe të gjitha detyrimet e vendosura ndaj VB Albania;
- Çdo kërkesë, mosmarrëveshje, padi dhe procedurë kundrejt çdo Autoriteti ku VB Albania është palë;



- Çdo dhe të gjitha detyrimet që i atribuohen VB Albania, duke përfshirë detyrimet e pasigurta, detyrimet potenciale dhe detyrimet e ardhshme të VB Albania të cilat kanë ndodhur tashmë etj.

Nëse pëlqimi i një kreditori ose i një pale të tretë është i nevojshëm për transferimin e aktiveve të caktuara, VB Albania dhe ISP Albania do të përpiqen, nëpërmjet përpjekjeve më të mira, ta sigurojnë atë;

ISP Albania do të marrë në zotërim të gjitha librat, korrespondencën, të dhënave operative dhe të dhënave të tjera të biznesit që ruan dhe mban VB Albania. ISP Albania gjithashtu do të marrë në zotërim çdo dhe të gjitha instrumentet dhe dokumentet e nevojshme për të paraqitur të drejtat që i janë transferuar asaj. ISP Albania do të mbajë librat, korrespondencën, të dhënat operative dhe të dhënat e tjera të biznesit të VB Albania sipas dispozitave të kuadrit ligjor shqiptar.

Sikundër rezulton nga Plani i Bashkimit dhe Marrëveshja e Bashkimit nuk është e përshtatshme zmadhimi i kapitalit të regjistruar të ISP Albania pas Bashkimit si dhe përcaktimi raportit të këmbimit të aksioneve, ndonjë pagesë në mjete monetare cash ose kushtet e ndarjes së aksioneve në Shoqërinë Përthithëse (ISP Albania). Në mënyrë të veçantë, pas bashkimit (i) kapitali i regjistruar i Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a mbetet 5.562.517.674,00 lekë; (ii) numri i aksioneve mbetet 15,581,282; 3) vlera nominale për aksion do të mbetet 357,000 lekë. Bazuar në sa më sipër dhe duke pasur parasysh se bankat janë në pronësi të të njëjtit aksioner, sipas opinionit tonë, qasja e mos përfshirjes së raportit të këmbimit të aksioneve është i përshtatshëm.

(5) Konkluzionet:

- Sipas opinionit tonë, qasja e propozuar nga drejtimi i bankave të bashkuara ishte e përshtatshme duke marrë në konsideratë se ky bashkim nuk do të përfshijë raportin e këmbimit të aksioneve, shumën e çdo pagese në mjete monetare cash ose kushtet e ndarjes së aksioneve në Shoqërinë Përthithëse. Gjatë vlerësimit dhe shqyrtimit të Planit të Bashkimit dhe Marrëveshjes së Bashkimit nuk kemi identifikuar ndonjë çështje të veçantë në lidhje me aktivitetet e bashkimit të Bankave.
- Kufizimi i përdorimit - ky opinion është përgatitur vetëm për qëllimet e specifikuar në Seksionin IX të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare.
- Ky opinion duhet lexuar së bashku me Planin e Bashkimit dhe Marrëveshjen e Bashkimit të datës 4 Maj 2018 dhe me shtojca.

DK Audit ShPK

Ilir Daiu

Audituesi ligjor